

Statuti i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar
"*BID Invest*"sh.p.k.

Ne Këtë Statut:

- **"Ligji"** është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 " Për Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" me ndryshimet qe i behen here pas here;
- **"QKB"** do te thote Qendra Kombetare e Biznesit
- **"Statuti"** është ky statut i shoqerise;
- **"Shoqeria"** është shoqeri tregtare "BID Invest" SHPK"

KREU 1
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

NENI 1
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, me 28 Qershor 2022(Dymije e njezetedy), Une themeluesi, Krijoj një shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin "BID Invest" SH.P.K.

Themeluesi dhe Ortaku i vetem i Shoqerise është:
Aldoljan Ziso, lindur ne Durres, Shqiperi. Me 25.07.1978, banues ne Rruga: "Marko Bocari", Pallati TID, dyqani nr.10, Tirane, Shqiperi, me numer personal H80725199D, dhe numer leternjoftimi 033546479, leshuar nga Ministria e Puneve te Brendshme me:19.12.2017.

NENI 2
Objekti

Ndertimin e objekteve dhe punimeve civile dhe industriale, projektim, studim, zbatim. Montim catish dhe ulluqesh. Ndertim te projekteve ujore, hidrocentrale, ujesjelles e kanalizime, spitale dhe/ose objekteve me siguri te larte, rruge dhe hekurudha. Pune te tjera ndertimore perfshire profesione te vecanta. Instalimin e pajisjeve elektrike. Izolim. Instalime te tjera. Suvatim. Instalim mobiljesh. Punime te tjera perfundimtare Tregti me shumice e pajisjeve elektroshtepiake dhe materiale ndertimi te cdo lloji. Fabrikim i pajisjeve te nevojshme elektrike. Fabrikimin e valvulave dhe tubave elektronike dhe pajisjeve te tjera per radio dhe televizore. Fabrikimin e televizoreve dhe radio trasmetuesve dhe aparaturat per linja telefonie dhe telegrafie. Aktivitete arkitekturore dhe inxhinierike dhe konsulencat perkatese. Testime dhe analiza teknike. Reklama. Aktivitete per sherbimet ndaj zjarrit. Import-eksport me qellim rishitjen e te gjitha materialeve te ndertimit dhe te tjera. Studim i tregut ne sektorin e ndertimit, materialeve te ndertimit, tekstileve dhe sherbimeve te lidhura me to, si dhe produktet ushqimore, perfshire te gjithe teknologjine e industrise te perpunimit te produkteve te cfaredo lloji. Tregti e produkteve farmaceutike, parafarmaceutike, dhe pajisje mjeksore, kozmetike ne pergjithesi dhe prodhimin dhe tregtimin e produkteve qe rrjedhin

nga bimet officinale. Te marre pjese ne tendera dhe gara private ose publike, ndertimi dhe restaurimi per objekte te te gjitha llojeve, per vete apo te trete. Shitja dhe dhenia me qira e tokes dhe ndertesave te gjitha llojeve, blerjen dhe dhenien me qira te pasurive te patundshme te gjitha llojeve, administrimin dhe menaxhimin e pasurive te patundshme te cdo lloji dhe cdo veprimtari tjetër te lidhur me industrine e ndertimit ketu gjithashtu perfshire edhe projektimin nese kerkohet nga bleresi, nga tenderuesi. Organizimi i aktiviteteve argetuese dhe reklamuese ne fushen e modes, etj. Krijimi, administrimi, organizimi, ristrukturimi i salloneve zinxhir ne fushen e modes dhe pjesmarrja ne eventet e organizuara ne Republiken e Shqiperise dhe jashte saj. Veshje per meshkuj dhe femra, per femije dhe te rritur, etj. Tregti me pakice e shumice, ne qendra fiks dhe ambulate dhe artikuj veshje, aksesore, kepuce, veshje sportive dhe artikuj bizhuteri. etj. Import, eksport per produkte ushqimore, etj. Sherbime mbeshtetese per aktivitetet turistike, sportive etj. Agjenci prenotimi per hotele, qiradhenie automjetesh, mjetesh lundrues per perdorim privat, publik etj. Qiradhenie banesash, garazhe, mjete motorrike. etj. Kryerja e veprimtarive dhe/ose pjesemarrja ne cdo veprim ose aktivitetet qe ka lidhje me reklamimin, promovimin, sponsorizimin dhe ndermjetesimin ne fushen e modes ne pergjithesi si ne Republiken e Shqiperise dhe jashte saj. Ushtrimi i aktiviteteve qe rrjedhin apo qe ndihmojne ne realizimin e objektivave te mesiperme kryesore. Marrja e financimeve nga institucione te ndryshme kredie, nga shoqeri, ente publike apo private, ne kuader te realizimit te veprimtarise se saj duke dhene garancite e nevojshme imobiliare, reale dhe personale. Kryerja e cdo lloj veprimtarie tjetër te nevojshme ose te dobishme ne kuader te realizimit te qellimeve te Shoqerise.

NENI 3 **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete e pakufizuar.

NENI 4 **Selia**

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: SELITE, Rruga Kroit, Nd.8, H.2, Ap.9, Selite, Farke, 1044, Tirane.

KREU 2 **KAPITALI**

NENI 5 **Kapitali themeltar**

1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 Leke (Njeqind Leke) i përbeherë nga 1 (nje) kuote.
2. I gjithë kapitali themeltar është nënshkruar nga Ortaku si ne vijim:

Z. Aldoljan Ziso, ka nënshkruar një kuotë me vlerë 100 Leke (njeqind Leke) që përben 100% (njeqind përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Ortaku ka paguar vlerën e kapitalit themeltar.

3. Kuota e kapitalit është e transferueshme dhe mund të transferohet në çdo moment sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë statut dhe atyre të parashikuara nga ligji shqiptar.

NENI 6
Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i Shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se Administratorit.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimine statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

NENI 7
Transferimi i Kapitalit

Kuotat e kapitalit te Shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet çdo menyre te parashikuar me ligj. Pjeset e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne Statut.

KREU 3
ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 8
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarrës i Shoqerisë.

Asambleja e Ortakeve miraton çdo ndryshim të Statutit sipas modaliteteve te peraktuara në Ligj.

Asambleja e Ortakëve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per Shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratorin/administratoreve;
- d) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- e) percaktimin e shperblimeve per personat permendur ne shkronjat "c" dhe
- f) " d " te kesaj pike;
- g) Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- h) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
- i) Zmadhim dhe zvogelimin e kapitalit;
- j) Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- k) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe be procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- l) Riorganizim dhe prishjen e shoqerise;
- m) Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- n) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo Statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne Asamblene e Ortakeve ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete:

Administratori i Shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues i ortakeve ne

Asamblene e Ortakeve.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Ortakeve, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

NENI 9

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Ortakeve

Asambleja e Ortakeve thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike ne adresat e njoftuara nga ortaket. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese. Kur Asambleja e Ortakeve nuk eshte thirrur sipas paragrafit te mesiperme te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakord per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

NENI 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asambleja e Ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave. Ne rastin kur Asambleja e Ortakeve duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te Ligjit, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te Ligjit. Nese Asambleja e Ortakeve nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi, te permendur me lart, ajo mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e Ortakeve vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e Statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise.

Asambleja e Ortakeve vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te Shoqerise;
- b) emerimin e shkarkimin e administratorin/administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve;
- e) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga Administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj Administratore;
- g) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

Çdo Ndryshim i Statutit duhet te depozitohet prane QKB për te pasqyruar ndryshimet ne skeden e Shoqerise.

Neni 12

Perjashtimi nga e drejta e votes

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejtene votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim për:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqeria
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 13 Administrimi

Asambleja e Ortakeve emerone nje Administrator te Shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 (pese) vjet me te drejte riprteritje. Emerimi i Administratorit prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i Shoqerise per nje afat 5 vjecar:
Te dhenat e identifikimit: - **Aldoljan Ziso**, shtetas shqiptar, lindur ne Durres, Shqiperi, me 25.07.1978, me numer personal H80725199D.

Neni 14 Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të :

- a) Te kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare te Shoqërisë , duke zbatuar politikat tregtare , të vendosura nga Asambleja e Ortakëve;
 - b) përfaqësojë Shoqërisë
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqerise
 - d) përgatisë dhe nënshkruaje bilancin vjetor , bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve , i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Ortakëve për miratim;
 - e) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqerise;
 - f) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë , siç parashikohet në ligjin për QKB .
 - g) raporton përpara Asamblesë së Ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë Shoqërisë tregtare ;
 - h) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në Statu
- . Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Ortakëve në rastet kur
- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare , rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim .
 - Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive , të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të Shoqërisë , që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara .
 - Shoqëria , brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj , propozon të blejë nga një ortak pasuri , që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të Shoqërisë , që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara .

Asambleja e Ortakëve mund të shkarkojë Administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme . Paditë , që lidhen me shpërblimin e Administratorit , në buzë të marrëdhënieve kontraktore me Shoqërinë , rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15 **Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht , ndaj Shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë. Pasoja të marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm Shoqërisë , i ngarkohen Administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen , për të përballuar në menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse . Përveç sa është parashikuar në dispozitat e pergjithshme të detyrimit të besnikërisë , sipas neneve 14 , 15 , 17 e 18 të ligjit . Administratori detyrohet

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në Statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi , duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në Statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet , për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit , prezent apo të mundshem , interesave personale me ata të Shoqërisë ;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm .

KREU IV **VITI FINANCIAR-EKSPERTET**

Neni 16 **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përbashimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në QKB dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 17 **Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të Shoqërisë , atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara , të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë ne kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka .

KREU V **PRISHJA - RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

Neni 18 **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e Shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë .

- a) me vendim të Asamblese se Ortakëve;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;

c) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast , Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të Shoqërisë, duke caktuar I apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese “Shoqëri në likuidim”. Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve , brenda 30 ditëve pas prishjes , çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues .

Neni 19

Riorganizimi i Shoqërisë , bashkimi – ndarja

Shoqëria mund të ndahet , bashkohet sipas Vendimit të Asamblest se Ortakëve , në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit .

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e Ligjit, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarreveshjet

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statusi, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve do të jetë Kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 22

Ky Statut përpilohet në 4(katër) kopje origjinale me vlerë të njëjtë ligjore në gjuhën shqipe. Statuti mbyllet me 22(njëzet e dy) nene.

Ky Statut do të shërbejë gjithashtu si Akt i Themelimit të shoqërisë së re dhe do të regjistrohet në Regjistrin Tregtar me depozitim të këtij dokumenti të nënshkruar.

Autorizohet Administratori i shoqërisë të kryejë gjithë veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë në QKB.

ORTAKU THEMELUES

ALDOLJAN ZISO

Aldoljan Ziso

